



ACCESS për nxënësit e gjuhës angleze (ELL-të)

Çfarë është provimi ACCESS?

Vlerësimi i komunikimit dhe të kuptuarit në anglisht nga shteti në shtet për nxënësit e gjuhës angleze (ACCESS for ELLs™ - ACCESS për ELL-të) është një provim i zotërimit të gjuhës angleze bazuar në standarde për nxënësit në klasat K-12 i përpiluar për të matur zotërimin e anglishtes nga nxënësit e gjuhës angleze. Ai vlerëson anglishten sociale dhe mësimore si dhe gjuhën që lidhet me artet gjuhësore, matematikën, shkencën dhe studimet sociale brenda kontekstit të shkollës përgjatë katër fushave gjuhësore të dëgjimit, të folurit, leximit dhe shkrimit.

Kush e jep provimin ACCESS?

Kërkohet që të gjithë nxënësit e anglishtes në klasat K-12 të marrin pjesë çdo vit në një vlerësim të zotërimit të gjuhës angleze.

Si identifikohen nxënësit e anglishtes?

Nxënësit e anglishtes identifikohen nëpërmjet një procesi i cili fillon duke u kërkuar familjeve që të plotësojnë një pyetësor për gjuhën në shtëpi. Pas plotësimit të pyetësorit, më pas kryhet një intervistë me familjen për të vendosur nëse nxënësi mund të jetë nxënës i anglishtes. Në qoftë se vendoset që nxënësi mund të jetë nxënës i anglishtes, i bëhet më pas një kontroll paraprak për zotërimin e gjuhës angleze.

Kur do ta japë provimin ACCESS fëmija im?

Provimi ACCESS u bëhet nxënësve të anglishtes çdo vit. Ju duhet të shikoni [Kalendarin e vlerësimeve të SDP-së](#) si dhe kalendarin e shkollës së fëmijës suaj për datat specifike se kur do të kryhet provimi ACCESS në shkollën e tij.

Çfarë bëjnë mësuesit me rezultatet e provimit ACCESS të fëmijës tim?

Rezultatet e provimit ACCESS përdoren nga mësuesit për të monitoruar përparimin e nxënësve drejt zotërimit të anglishtes, për të planifikuar në mënyrë të qëllim të skela për mbështetjen e nxënësve që të kenë qasje në përmbajtjen e nivelit të klasës, për të marrë vendime në lidhje me krijimin e regjistrave dhe caktimin e mbështetjes për lëndë të përshtatshme ose klasa dhe për të përcaktuar riklasifikimin nga programet arsimore të mësimdhënies së gjuhës.

Çfarë lloj pyetjesh bëhen në provimin ACCESS?

Nxënësit testohen në katër fushat gjuhësore: **lexim, shkrim, të folur dhe dëgjim**. Ka tri lloje mënyrash për përgjigje: 1) me shumë zgjedhje (dëgjimi dhe leximi); 2) përgjigje të dhëna me gojë (të folurit); dhe 3) përgjigje të dhëna me shkrim (shkrimi).

Çfarë lloj rezultatesh raportohen në provimin ACCESS?

Provimi ACCESS ofron tri lloje rezultatesh: rezultatet origjinale, rezultatet e shkallëzuara dhe rezultatet e nivelit të zotërimit. **Rezultatet origjinale** janë vetë numri i njësive ose detyrave të sakta. Ky rezultat është fillimi por, për shkak se nuk merr parasysh vështirësinë e njësive, nuk i ndihmon arsimtarët që të kuptojnë arritjet e nxënësit. Për këtë arsye, rezultatet origjinale nuk përfshihen në raportet e rezultateve ACCESS për ELL-të. **Rezultatet e shkallëzuara** marrin parasysh vështirësinë e njësive me qëllim që arsimtarët të mund t'i përdorin ato për të ekzaminuar grupe nxënësish ose arritjet e nxënësve me kalimin e kohës. **Rezultatet e nivelit të zotërimit** ofrojnë interpretimin e rezultateve të shkallëzuara. Ekzistojnë gjashtë nivele të zotërimit të gjuhës angleze: 1–në hyrje e sipër, 2–në shfaqje e sipër, 3–në zhvillim e sipër, 4–në zgjerim e sipër, 5–në lidhje e sipër, dhe 6–në arritje e sipër.

A ka afat kohor provimi ACCESS?

Provimi ACCESS nuk ka afat kohor. Përpiluesit e provimit përlogarisin që segmenti i leximit mund të zgjasë deri në 60 minuta, segmenti i dëgjimit mund të zgjasë deri në 65 minuta, segmenti i të folurit mund të zgjasë deri në 50 minuta dhe segmenti i shkrimit mund të zgjasë deri në 90 minuta, pra gjithsej 265 minuta provim. Megjithatë, nxënësve nuk u kërkohet që ta mbarojnë provimin vlerësues brenda kësaj periudhe kohore dhe atyre u jepet kohë shtesë sipas nevojës për ta mbaruar provimin.

A ndikon provimi ACCESS në notat e fëmijës tim?

Ky provim nuk ndikon në notat e nxënësve. Megjithatë, rezultatet e kombinuara ACCESS (të referuara gjithashtu si “nivelet e zotërimit të anglishtes”) - të cilat variojnë nga 1.0 në 6.0 – japin informacion për vendimet e regjistrimit ose vendosjen në kurset/klasat e përshtatshme.

Si do ta japë provimin ACCESS fëmija im?

Provimi ACCESS mund të bëhet në mënyrë dixhitale ose me laps dhe letër. Pavarësisht se cilin version do të bëjë fëmija juaj, të gjithë nxënësit duhet ta japin provimin ACCESS fizikisht në shkollën e tyre.

Ku mund t'i gjej rezultatet e provimit ACCESS?

Çdo fëmije që jep provimin ACCESS do t'i dërgohet në shtëpi raporti individual i nxënësit nga shkolla e tij. Për mbështetje të mëtejshme në kuptimin e Raportit individual të studentit të fëmijës suaj, ju mund të konsultoheni me mësuesin EL të fëmijës suaj.

Kë mund të kontaktoj për pyetje të mëtejshme në lidhje me provimin

ACCESS?

Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme për provimin ACCESS, ju rekomandojmë që të lidheni me shkollën e fëmijës suaj. Informacioni i kontaktit të shkollës së fëmijës suaj mund të merret nga [uebsajti i profileve të shkollave](#) të SDP-së.

Ku mund të gjej informacion shtesë për provimin ACCESS?

Zyra e Vlerësimeve të Rajonit Shkollor të Filadelfias: philasd.org/era/assessment

[Pennsylvania Department of Education's ACCESS homepage](#)